

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLË SË PARË TIRANË
Nr. 22438 / 5

VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM
për depozitim aktesh personi juridik

Sot, më datë 29 Mars 2002, unë Enkela Bajo, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga Z. Emmanuel Papathnassiou dhe Z. Stavros Tzouvelekis në cilësinë e Administratorëve të Shoqërisë “ELDA PETROLEUM ALBANIA” SHPK, për depozitim të Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria “ELDA PETROLEUM ALBANIA” SHPK është person juridik i së drejtës shqiptare e regjistruar me Vendimin Nr. 22438, datë 15 dhjetor 1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe ka për Ortak të Vetëm shoqërinë “GLOBAL PETROLEUM ALBANIA” SHA e cila zotëron 100 për qind të pjesëve të kapitalit të saj.

Me vendimin e datës 11 Mars 2002, të Mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakut të Vetëm, shoqërisë “GLOBAL PETROLEUM ALBANIA” SHA, është marrë vendimi për:

Miratimin e raportit të ekspertit kontabël të autorizuar, Z. Berti Pashko për vlerësimin e kontributeve në natyrë të shoqërisë duke përfshirë asetet e shoqërisë GLOBAL SHPK të cilat i janë transferuar filialit të saj “ELDA PETROLEUM ALBANIA” SHPK pas likuidimit të shoqërisë GLOBAL SHPK.

Miratimin e zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë me kontribute në natyrë, me vlerën 12 092 718 lekë (dymbëdhjetë milionë e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë lekë).

Pas zmadhimit të kapitalit, vlera e përgjithshme e kapitalit themeltar të shoqërisë “ELDA PETROLEUM ALBANIA” SHPK është: kontribute në para 100 742 500 lekë (një qind milionë e shtatëqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind lekë) dhe kontributet në natyrë në vlerën 12 092 718 lekë (dymbëdhjetë milionë e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë lekë).

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e cmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”,

VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;

- Depozitim e Vendimit të datës 11 Mars 2002, të Mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakut të Vetëm, shoqërisë "GLOBAL PETROLEUM ALBANIA" SHA për:

1) Miratimin e raportit të ekspertit kontabël të autorizuar, Z. Berti Pashko për vlerësimin e kontributeve në natyrë të shoqërisë duke përfshirë asetet e shoqërisë GLOBAL SHPK të cilat i janë transferuar filialit të saj "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK pas likuidimit të shoqërisë GLOBAL SHPK.

2) Miratimin e zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë me kontribute në natyrë, me vlerën 12 092 718 lekë (dymbëdhjetë milionë e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë lekë).

Pas zmadhimit të kapitalit, vlera e përgjithshme e kapitalit themeltar të shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK është: kontribute ne para në vlerën 100 742 500 lekë (një qind milionë e shtatëqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind lekë) dhe kontribute në natyrë në vlerën 12 092 718 lekë (dymbëdhjetë milionë e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë lekë).

- Urdhërohet zyra e Regjistrimit Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

ENKELA BAJO

